



Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Sarandë

Viti 2019

Ky raport është hartuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH), në kuadrin e projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të lidhura me reduktimin e dhunës në familje të “Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020”. Projekti zbatohet në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave”, financuar nga Qeveria e Suedisë dhe që po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë

Përmbajtja e këtij manuali është vetëm përgjegjësi e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim, dhe nuk reflekton opinionin e SIDA, UNDP, UNFPA dhe UN Women.

Autorët

Ilda Boçi – Shoqata Jona Sarandë

Esmeralda Hoxha – Qendra “Aleanca Gjinore për zhvillim”

Tabela e Permbajtjes

TABELA E PERMBAJTJES	3
HYRJE	5
PËRSE MONITORIM I SKBGJ-SË NGA OSHC-TË?	6
METODOLOGJIA	6
TË DHËNAT TË PËRGJITHSHME TË BASHKISË SARANDË	8
MONITORIMI I QËLLIMIT STRATEGJIK TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2019	8
GJETJET KRYESORE	8
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE NË BASHKINË SARANDË	9
TË DHËNA STATISTIKORE NGA MEKANIZMI I REFERIMIT SARANDË	9
TË DHËNA STATISTIKORE NGA DREJTORIA E POLICISË SARANDË.....	10
TË DHËNA STATISTIKORE NGA PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR SARANDË.....	11
REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2019	12
KONKLUZIONE	19
REKOMANDIME	20

Shkurtime

ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BGj	Barazia Gjinore
DhBGj	Dhunë me bazë Gjinore
DhF	Dhunë në Familje
GTN	Grupi Teknik Ndërdisciplinor
INSTAT	Instituti i Statistikave në Shqipëri
KONVENTA CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KONVENTA E STAMBOLLIT	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
KD	Komiteti Drejtues
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGj	Nëpunës i Barazisë Gjinore
NjVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
QAGjZh	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
QZHK “Sot për të Ardhmen”	Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”
REVALB	Sistemi elektronik (on-line) i regjistrimit të rasteve të dhunës në Shqipëri
RrFGSh	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
SKBGj	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
ShGPS	Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës
UM	Urdhër Mbrojtjeje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UN WOMEN	Entitet i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Hyrje

Ky raport u hartua në kuadër të Projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të OShC-ve për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve në lidhje me zvogëlimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020, nën Programin e Përbashkët të KB "Përfundimi i Dhunës ndaj Grave" të financuar nga Qeveria e Suedia po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA në partneritet me Qeverinë shqiptare Në Shqipëri projekti u zbatua nga Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, nga disa nga anëtarët e Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri dhe disa organizata të tjera joqeveritare. Bashkitë e përfshira në monitorim ishin bashkitë e Lezhë, Kamëz, Fier, Sarandë dhe Pogradec.

Qëllimi i projektit është monitorimi i i detyrimeve ndërkombëtare dhe kombëtare të Shqipërisë për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndërsa rezultati i pritur në terma afatgjatë është ulja e fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri. Proçesi monitorues i SKBGj dhe PKV 2016-2020 pr bashkitë e lartpërmenduar u zhvillua përgjatë periudhës nëntor 2019- Maj 2020. Aktivitetet në nivel qendror u monitoruan nga QAGjZh dhe në nivel lokal nga disa prej anëtarëve të RrFGSh i dhe disa organizata të tjera, përmes mbledhjes së të dhënave zyrtare lidhur me zbatimin të Qëllimit strategjik 3 të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016 – 2020.¹

Gjatë zbatimit të projektit u arrit që:

1. Organizatat partnere në projekt të rrisin për të monitoruar zbatimin e Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020 dhe punën e mekanizmave të referimit kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.
2. Procesi i monitorimit nga u përfundua me sukses brenda afateve të zbatimit të projektit pasi edhe pse nën ndikimin e krizës COVID-19, institucionet përgjegjëse dërguan në kohën e duhur informacionet e kërkuara zyrtarisht.
3. U realizua procesi i promovimit dhe advokimit, për zbatimin e objektivit të 3-të të SKBGj 2016-2020, duke përdorur gjetjet dhe rekomandimet e proceseve monitoruese.

Ky projekt, e nisi punën me organizimin e seancave informuese me përfaqësuesit e organizatave partnere në 5 bashkitë nën monitorim, bazuar në udhëzuesin për monitorimin e Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, të realizuar nga GADC në nëntor 2019. Përveç manualit u hartuan skedat monitoruese bazuar në indikatorët për monitorimin e zbatimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, të cilat u përdorën gjatë procesit të monitorimit

Rreth organizatave zbatuese

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGjZh) është një organizatë jo-fitimprurëse shqiptare që vepron dhe punon në të gjithë Shqipërinë për fuqizimin e grave dhe për të krijuar një të ardhme të barabartë dhe të drejtë për vajzat dhe gratë me të ardhura të ulëta në të gjithë Shqipërinë, duke u përpjekur për t'i nxjerrë nga varfëria dhe përjashtimi. Për të mbrojtur të drejtat e grave dhe për t'i fuqizuar ato, QAGjZh ngre fonde kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fushat kryesore të ekspertizës së QAGjZh-së janë:

- Promovimi i paqes dhe përpjekjet për ti dhënë fund dhunës me bazë gjinore;
- Garantimi i fuqizimit ekonomik të grave;

¹ <https://www.un.org.al/sites/default/files/SKGJB-AL-web.pdf>

- Sipërmarrjet e grave;
- Fuqizimi i qytetarëve për të monitoruar axhendën gjinore lokale;
- Rritja e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Përmirësimi i të drejtave të grave në zona rurale.

Gjatë procesit të monitorimit të bashkive Fier, Lezhë, Pogradec, Sarandë dhe Kamëz QAGJZh bashkëpunoi me një pjesë të organizatave të Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri - RrFGSh , si dhe me disa organizata të tjera të cilat veprojnë në territorin e bashkive nën monitorim si: Qendra Rinore Vlorë, Epoka e Re Fier, Tjetër Vizion Elbasan dhe Shoqata për Integrimin e Zonave Informale Kamëz.

Përse monitorim i SKBGj-së nga OShC-të?

Përgjegjshmëria në qeverisje është një element i rëndësishëm që përcakton marëdhëniet midis atyre që ushtrojnë fuqinë e pushtetit dhe atyre në emër të të cilëve ushtrohet kjo fuqi. Në sistemet demokratike, fuqizimi i sistemeve të transparencës dhe përgjegjshmërisë është prioritet i vazhdueshëm, që sigurohet përmes mekanizmeve të ndërtuar, që përmirësohen vazhdimisht e që garantojnë pjesëmarrjen aktive në vendimmarrjen publike të shoqërisë civile, OShC-ve apo vetë përfaqësuesve të komuniteteve lokale. Këto mekanizma forcojnë proceset demokratike, sigurojnë zhvillim efektiv përmes dhënies së shërbimeve efektive, lehtësojnë procesin e mirëqeverisjes dhe fuqizojnë grupet më vulnerabël të komuniteteve, siç janë vajzat e gratë viktime të dhunës në familje.

Ndërkohë që ligjet dhe strategjitë kombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e vajzave e grave dhe dhunën në familje/ me bazë gjinore janë hartuar me kontributin e vyer e të pakursyer të OShC-ve të grave, deri tashmë kjo rutinë nuk është shoqëruar me procese monitoruese e vlerësuese nga vetë OShC-të. Organizatat e grave në Shqipëri kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme për të monitoruar dhe vlerësuar strategjitë dhe planet e veprimit në fushën që ato punojnë çdo ditë. Mbi të gjitha, ato për shumë vite kanë luajtur një rol vendimtar në adresimin e dhunës ndaj grave nëpërmjet ofrimit të shërbimeve, rritjes së ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve, lobimit dhe avokimit, duke u bërë kështu aktorë kyç në nivel vendor e kombëtar.

OShC-të janë shumë të interesuara që të monitorojnë strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit, në mënyrë që të ketë një të kuptuar më të mirë të asaj që qeveria po bën në këtë drejtim. Qëllimi përfundimtar është që të zbatojmë një proces monitorimi të paanshëm që do të sigurojë një zbatim më të mirë të hapave të ardhshëm që do ndërmerren për reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe avancimin e barazisë gjinore në shoqëri. Vlen të theksohet se Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS), e ka mirëpritur këtë nismë dhe ka theksuar se ky monitorim nga shoqëria civile do të shërbejë për të informuar edhe procesin e monitorimit të brendshëm të SKBGj 2016-2020 nga institucionet përgjegjëse.

Metodologjia

Për të kryer monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2016-2020 dhe Planit të Veprimit u ndoq një qasje e dyfishtë metodologjike në mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore. Një eksperte lokale u përzgjedh për çdo bashki të targetuar të ngarkuara për të ndjekur punën e bashkisë përkatëse dhe mbledhjen e të dhënave për periudhën janar – dhjetor 2019.

Procesi i mbledhjes së të dhënave është kryer si më poshtë vijon:

1. Mbledhja e të dhënave përmes takimeve informuese me zyrtarë lokal publik. Faza e parë ishte kontakti me kryetarët e bashkive të targetuara për njoftimin e tyre mbi iniciativën e monitorimit. Më pas monitorueset kontaktuan përmes një formati të njësuar koordinatorin vendor të dhunës pranë bashkisë dhe kurdo që ishte e mundur drejtorinë e shërbimeve sociale, drejtorinë e

shëndetit, organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në territorin e bashkisë, zyrtarët e gjykatave të rrethit, komunitetet fetare, mediat, organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të përfshirë në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Qëllimi i këtyre takimeve ishte vendosja e kontaktit që më pas u ndoq me kërkesa për informacion, të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera mbi punën e kryer nga bashkia dhe institucione të tjera për adresimin e objektivit të tretë të SKBGj për eliminimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Monitorueset gjithashtu kanë ndjekur takimet e zhvilluara në kuadër të mekanizmit të referimit në bashki dhe kanë raportuar mbi përmbajtjen e tyre dhe vendimet e marra.

2. Mbledhja e të dhënave përmes burimeve zyrtare e statistikore. Përmes të drejtës për informim monitorueset kanë kërkuar të gjithë dokumentet mbështetëse të punës së bashkisë në kuadër të luftës kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Specifikisht:

- Janë mbledhur minutat mbi takimet e mekanizmit të referimit për çdo bashki, që kanë plotësuar informacionet e ndara me monitorueset përmes intervistave.
- Janë marrë të dhëna statistikore mbi prevalencën e dhunës në familje nga gjykatat, shërbimi i provës, bashkia, policia, shërbimi social dhe INSTAT.
- Është analizuar buxheti vjetor i bashkisë për të identifikuar burimet financiare të alokuara për zbatimin e SKBGj në luftën kundër dhunës në familje.
- Janë mbledhur materiale mbështetëse për aktivitetet ndërgjegjëse të zhvilluara nga ana e bashkisë për përmbushjen e objektivit 3.1.

Raporti i monitorimit ndjek strukturën e objektivave specifike të SKBGj sa i përket dhunës me bazë gjinore si edhe aktivitetet specifike të planit të veprimit. Për këtë është hartuar një skedë monitoruese e cila është plotësuar në vijimësi nga monitorueset përmes informacionit të akumuluar përgjatë periudhës monitoruese.

Bazuar tek skeda monitoruese është bërë vlerësim i përmbushjes së angazhimeve të bashkive të targetuara nën objektivin e tretë të SKBGj duke identifikuar nga njëra anë praktikat pozitive prej të cilave mund të përfitojnë edhe bashki të tjera dhe nga ana tjetër sfidat dhe mangësitë me të cilat përballen bashkitë, për të identifikuar mundësitë për përmirësim në periudhën e mbetur të planit të veprimit të SKBGj.

Për të kryer monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore janë përdorur edhe të dhënat e sistemit REVALB. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UNDP ka hartuar dhe miratuar bazën e nevojshme ligjore për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Bashkërendimit të Punës dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje në mënyrë që të parandalohen, raportohen dhe trajtohen me efektivitet rastet e dhunës në familje.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, dt 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” përcakton midis të tjerave dhe detyrimet konkrete të institucioneve shtetërore përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, raportimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Sistemi online në lidhje me statistikën për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel bashkie është lançuar në vitin 2014. Ky sistem online regjistron çdo rast dhune, monitoron si po ecën referimi i rastit dhe ku ka ngecur ai, duke siguruar që t’i shkojë deri në fund çdo rasti të raportuar të dhunës në marrëdhëniet familjare. Sistemi online është i sigurt dhe respekton fshehtësinë e të mbijetuarave të dhunës. Ai përdoret nga një numër i kufizuar i nëpunësve vendorë dhe qendrorë, të cilët janë trajnuar posaçërisht për përgjigjen ndaj dhunës në familje, fshehtësinë e të dhënave të së mbijetuarës dhe për përdorimin e sistemit. Ky sistem aksesohet nga të gjitha bashkitë në nivel lokal dhe MShMS në nivel qendror në adresën www.revalb.org

Mbi bazën e të dhënave të hedhura, sistemi prodhon raporte interaktive dhe të mundshme për t'u printuar në kohë reale të cilat kontribuojnë në: hartimin e politikave; matjen e efektivitetit të Grupeve Teknike Ndërdisciplinore (GTN) të ngritura në nivel lokal; përmirësimin e të dhënave statistikore të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal; në marrjen e masave për mirë-funksionimin e mekanizmit referues në të gjitha njësitë vendore; Kryerjen e analizave statistikore, për të identifikuar probleme si dhe fusha ku ka nevojë për ndërhyrje; për të shmangur të gjitha dyshimet për të dhënat e pavërteta ose shifrat e gabuara, që çojnë në rritjen e besimit dhe përmirësimin e shkallës së bashkëpunimit midis aktorëve dhe të atyre që përfitojnë prej saj.

Të dhënat të përgjithshme të bashkisë Sarandë

Sipas Censurit të vitit 2011 bashkia e re e Sarandës ka një popullsi prej 20,227 banorësh ndërsa në regjistrin civil rezultojnë si popullsi banuese 50,680 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 58.96 km².

Sipas censurit, densiteti i popullsisë në bashkinë e re është 343 banorë/km² ndërsa sipas regjistrin civil, popullsia është 859.56 banorë/km². Bashkia e re është pothuajse tërësisht urbane me përjashtim të fshatrave Shelegar dhe Çukë, ku fshati Çukë është praktikisht sërish zonë urbane pavarësisht denominimit zyrtar.

Monitorimi i Qëllimit Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2019

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2019 në Bashkinë Sarandë.

Gjetjet Kryesore

- Mekanizmi i Koordinuar i Referimit pranë bashkisë Sarandë gjatë vitit 2019 ka trajtuar 4 raste të dhunës në familje.
- Pranë Komisarariatit qendër Sarandë, përgjatë vitit 2019 janë evidentuar 77 raste të dhunës në familje.
Gjatë vitit 2019 janë evidentuar gjithsej 72 raste kërkesë padi për Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje, nga të cilat 68 në Komisariatin e Sarandës dhe 4 në Gjykatën e Rrethit Sarandë
- Sipas informacionit të Gjykatës së Rrethit Sarandë, gjatë vitit 2019 janë paraqitur 72 kërkesa të reja për Urdhër Mbrojtje dhe Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes.
- Pranë Shërbimit të Provës për vitin 2019 referuar janë 4 raste për dhunë në familje, nga të cilët 2 burra dhe 2 gra.
- Bashkëpunimi me Spitalin dhe Qendrat Shëndetësore paraqitet e mirë, por në asnjë rast nuk identifikohet nëse viktimat e dhunës në familje janë pajisur me raport mjeko-ligjor nga instanca përkatëse.
- Nga viktimat e dhunës në familje që kanë përfituar UM nga gjykata, 10 prej tyre janë trajtuar me ndihmë ekonomike prej 3000 lekësh të reja për çdo rast.
- Të gjitha viktimat e dhunës në familje marrin këshillim psiko-social nga organizatat e shoqërisë civile që operojnë në këtë territor, specifikisht, shoqata "Jona"

- Për vitin 2019 buxheti i bashkise Sarandë nuk parashikonte shpenzime për shërbimet për viktimat e dhunës në familje. Praktikiqisht janë të parashikuara vetëm pagat e 4 punonjësve të Zyrës së Shërbimeve Sociale në këtë bashki.
- Kordinatorja Vendore në strukturë është e emëruar si “Specialiste për Mbrojtjen e të Drejtave të Grave dhe Fëmijëve të Dhunuar”, ndërkohë që ka ngarkesë nga mbivendosja e funksioneve si, “NJMF” (Njesia për Mbrojtjen e Fëmijëve); “Pikë Fokale për PAK” (persona me aftësi të kufizuar); “Kordinatore e Dhunës” dhe “Barazia Gjnore”.
- Numri i pjesëmarrësve në takimet ndërgjegjësuese për ç’do aktivitet ka qënë 40 persona pjesëmarrës, ku grupet e targetuara janë kryesisht gra kryefamiljare, gra me ndihmë ekonomike me fëmijë, nxënës, arsimtarë, administratë dhe qytetarë të komunitetit.
- Në kuadër të dhunës në familje dhe fushatës ndërkombëtare “16 Ditë të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore”, Bashkia e Sarandës në bashkëpunim me Shoqatën e Gruas “Jona” dhe me mbështetje të Zyrës Arsimore dhe Komisarariatit Sarandë kanë zhvilluar 4 aktivitete sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese prindër/fëmijë.
- Mekanizmi i referimit në Bashkinë Sarandë është mbledhur 2 herë, këto takime janë të përbashkëta së bashku me GTN-në.
- Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Sarandë, në kuadër të funksionit të saj bashkëpunon me institucione si, Gjykata, Prokuroria, Bashkia Sarandë. Gjithashtu, ndërmjetësim me “Qëndrën e Shërbimeve të Praktikave Ligjore të Integruara” në Gjirokastrë. Si edhe këshillim psikologjik me shoqatën “Jona” në Sarandë megjithëse nuk ka një marrëveshje të nënshkruar.
- Pranë bashkisë Sarandë nuk ka programe të ofruara për rehabilitimin e dhunuesve.
- Formularët tip të plotësuar në polici në shumë raste nuk i kanë të gjitha të dhënat sidomos të dhunuesve, mungesë kjo që sjell edhe problematika në ndarjen e statistikave nga gjykata.

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Sarandë

Të dhëna Statistikore nga Mekanizmi i Referimit Sarandë

Mekanizmi i Referimit ka trajtuar vetëm një rast duke mobilizuar të gjithë anëtarët e këtij mekanizmi, por disa raste të dhunës në familje (+3 raste) përgjatë vitit kalendarik 2019 janë shqyrtuar me pjesëmarrje më të ulët nga aktorët e këtij entiteti, kjo duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat që ka patur rasti i referuar pranë kordinatorës vendore të bashkisë Sarandë. Zakonisht gjatë vitit 2019 rastet e referuara janë të përsëritura dhe nuk marrin vëmendje të veçantë, duke qënë se ato vijnë si shkak i konflikteve për pronën ku të dhunuarit në shumicën e rasteve janë pensionistë.

TABELA Nr. 1. Rastet e Dhunës në familje të trajtuara nga Mekanizmi i Referimit

Raste të trajtuara nga Mekanizmi i Referrimit	Përshkrimi i rastit
-Tetor 2019. 1 vit UM Viktima: Pensioniste, dhunë fizike/psikologjike nga l biri kundrejt saj dhe	Mbledhja e parë është zhvilluar më datë 08.10.2019 u diskutua rasti i zonjës nga Saranda, rast i përsëritur. Në të cilën dhunuesi (djali i viktimës) i cili dhunon edhe bashkëshorten, ka marrë masën arrest me burg në momentin e mbledhjes së MKR. Në këtë mbledhje u diskutua rreth rastit dhe mundësitë për ti dhënë zgjidhje por për një mobilizim më efektiv të

bashkëshortes së tij. Nën presion psikologjik 2 femijët e mitur të dhunuesit.	<p>mekanizmit u pa e arsyeshme të bëhej një mbledhje e dytë ku të ishin të pranishëm Gjykata dhe Zyra e Punës më datë 22.10.2019. Gjatë mbledhjes së dytë u diskutua për rastin si i përsëritur dhe i trajtuar më parë, lind dyshimi nga aktorët e mekanizmit se mund të ketë nevojë për egzaminim psikologjik për mundësinë e ndonjë çregullimi psikologjik.</p> <p>Gjatë mbledhjes aktorët e MKR kanë përcaktuar procedimin për ti dhënë një zgjidhje sa më efektive rastit në fjalë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i mundësisë për punësim për të dy bashkëshortët sipas profilit të tyre nga Zyra e Punës, për tu ulur shkalla e varfërisë e cila mund të jetë shkak për gjëndjen e dhunuesit. • Ndhma jetike, si paketa ushqimore, veshëmbathje nga Fondacioni Lidia. • Trajtim psiko-social nga bashkia dhe shoqata “Jona” • Trajtim me ndihme ekonomike si familje ne nevojë ku I perfiton 2500 leke të reja bashkëshortja e dhunuesit dhe 3000 lekë të reja si viktimë e dhunës mamaja (denoncuesja.) <p>Këto raste kontrollohen rregullisht, pasi, shihen me përparësi.</p>
Rregjistruar 09.11.2019 , 1 vit UM. Viktima: pensioniste e dhunuar psikologjikisht nga ish bashkëshortja e djalit për konflikte pronësie.	Nuk është bërë mbledhje për rastin, por trajtohet me ndihme si viktimë e dhunës dhe merr këshillim psikologjik pranë shoqatës “JONA”.
Viktima dhunohet psikologjikisht nga ish bashkeshorti. 6 muaj UM	Nuk është bërë mbledhje për rastin, por trajtohet me ndihmë si viktimë e dhunës dhe merr këshillim psikologjik nga organizatat e shoqërisë civile pranë kësaj bashkie.
Viktima grua, dhunohet psikologjikisht nga i ati. 1 vit UM.	Trajtohet me ndihmë ekonomike si viktimë e dhunës në familje.

Burimi: Kordinatori Vendorë, Bashkia Sarandë

Të dhëna statistikore nga Drejtoria e Policisë Sarandë

Përgjatë vitit 2019 pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Sarandë janë evidentuar 77 raste të dhunës në familje, 65 prej viktimave ishin gra/vajza. Ndërkohë që numri i rasteve të veprës penale “dhunë në familje” neni 130/a² për vitin 2019 ishte 23 dhe u arrestuan 9 autorë.

² **Neni 130/a Dhuna në familje** (Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 17; ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr.144, datë 2.5.2013, neni 33) – 130/a1Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet. 130/a2Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ishbashkëshort,

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2019, sipas Ligjit 9669, datë 18.12.2006, janë plotësuar 51 Kërkesë Padi për Urdhëra Mbrojtje.

Të dhënat e pasqyruara tregojnë statistikat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe numri i të dëmtuarve është më i madh se sa rastet e evidentuara, pasi në një vepër penale apo kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje mund të ketë më shumë se një person të dëmtuar.

Detaje më të hollësishme të ndara sipas zërave përkatës, pasqyrohen si vijon më poshtë:

Tabela 2: Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Bashkisë Sarandë

Përshkrimi	Komisariati Sarandë
Evidentuar	77
Të dëmtuar gjithsej	77
Prej tyre gra/vajza	65
Kërkesë për U. Mbrojtje	51
Shkelje U.Mbrojtjes	2
V. P. Neni 130/a	23
Arrest. për 130/a	9
Ndalar për 130/a	1
Gjendje të Lirë për 130/a	14
Në kërkim për 130/a	1
Autorë të vetërvare	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Të dhëna statistikore nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Sarandë

Sipas Propurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për vitin 2019 janë evidentuar 26 raste të dhunës në familje.

Nga këto raste, 16 janë kallëzime për Nenin 130/a/1. Ku, 10 janë në proces; 1 u pezullua për mos gjetje të autorit dhe është dërguar dosja në komisariatit e Sarandës; 5 raste kanë kaluar në gjykatë (3 raste, arrest me burg dhe 2 në gjendje të lirë).

Ndërkohë që janë 2 raste dhune në familje sipas Nenit 130/a/2, nga të cilat 1 është në proces dhe 1 dërguar në gjykatë ku është lënë në gjendje të lirë. Sipas Nenit 130/a/3 janë 8 proceduar raste gjithsej. 2 raste janë në proces; 4 raste kaluar në gjykatë (5 arrest me burg); 1 rast për I kaluar Gjyrokastres për mos kompetencë dhe 1 rast është nën Hetim.

Të dhëna statistikore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë

Sipas informacionit të Gjykatës së Rrethit Sarandë, gjatë vitit 2019 janë 72 kërkesa për Urdhëra të Menjëhershëm të Mbrojtjes, 2 raste janë të mbartura, 16 janë të rrëzuara, 4 të pushara, 4 në Apel, 3 kanë

bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet. 130/a3Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet. 130/a4Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet.

marrë formë të prerë. Gjykata nuk ofron të dhëna të ndara, ndaj të dhënat e mësipërme janë raste dhune në qytet dhe fshat, jo vetëm të bashkisë që monitorohet por edhe Finiqit, Konispolit, Delvinës dhe njësisë ADM Ksamil.

Të dhëna statistikore nga Shërbimi i Provës Sarandë

Pranë Shërbimit të Provës për vitin 2019 referuar janë 4 raste për dhunë në familje, nga të cilët 2 burra dhe 2 gra. Por, për rastet e dhunës në familje janë vetëm dy raste për të cilat Shërbimi i Provës Sarandë ka marrë masat e nevojshme si vijon:

1. Agresori 52 vjeç. Ka dhunuar fizikisht nusen e djalit për mosmarrëveshje. Detyrim paraqitje për një periudhë 12 mujore që prej datës 11.01.2019. Banuese në Ksamil. *(Neni 59)*
2. Agresori 38 vjeç. Ka dhunuar fizikisht bashkëjetuesen pas një konflikti të saj me të emën e tij. Detyrim paraqitje për një periudhë 5 vjeçare, që prej datës 10.01.2019. Banues në fshatin Gjashtë. *(Neni 59)*

Rezultatet e Monitorimit – Viti 2019

Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Bashkia e Sarandës nuk ka numër shumë të lartë të raportimit të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje nëse e krahasojmë me bashki të tjera, por jo numër i pandjeshëm për komunitetin. Nga monitorimi i zbatimit të strategjisë rezulton se rolin kryesor në fushatat ndërgjegjësuere në bashkinë e Sarandës e kryejnë Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) që punojnë në territorin e bashkisë, konkretisht Shoqata e Gruas "Jona" e cila është organizata kryesore me të cilën bashkëpunon bashkia Sarandë edhe pse nuk ka një Marrëveshje Bashkëpunimi të nënshkruar zyrtarisht.

Si rrjedhojë, Bashkia Sarandë për ndërgjegjësimin e shoqërisë në luftimin e fenomenit të dhunës me bazë gjinore, ka realizuar disa fushata ndërgjegjësuere për komunitetin. Duke koordinuar administratën e bashkisë me shoqatën e cila implementon projekte kundër dhunës në marrëdhëniet familjare dhe dhunës me bazë gjinore në bashkinë e Sarandës.

Përsa më sipër janë realizuar takime ndërgjegjësuere në bashkëpunim me Zyrën Arsimore Sarandë (shkollat e mesme dhe 9-vjeçare në qytet dhe fshatra) Shëndetësia (NJ.V.K.SH) dhe Komisarati i policisë Sarandë.

Në 16 ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore për vitin (2019) brenda territorit të bashkisë janë zhvilluar disa aktivitete ndërgjegjësuere me iniciativë të shoqërisë civile.

Numri i pjesëmarrësve në takimet ndërgjegjësuere në total ka qenë 30-60 pjesëmarrës për target grup, të cilat janë gra kryefamiljare me fëmije, gra që trajtohen me ndihmë ekonomike si të dhunuara dhe ndihmë sociale nga bashkia, nxënës, arsimtarë, punonjës administrate, qytetarë dhe fëmijë të familjeve me probleme sociale. Këto aktivitete janë zhvilluar brenda territorit të bashkisë Sarandë, konkretisht në:

- Qendër të qytetit;
- Shkolla e mesme “Hasan Tahsini” ;
- Shkolla 9-vjeçare në fshatin Gjashtë;
- Ambientet e Bashkisë Sarandë.

OSHC-të e përfshira në koordinimin e aktiviteteve për ndërgjegjësimin e shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunë në familje:

Shoqata e Gruas “Jona” Sarandë

Qëllimi i shoqatës është arritja e barazisë gjinore, duke mobilizuar të gjitha hallkat e shoqërisë, në zbatim të misionit të saj.

- Gjatë vitit 2019, ka ofruar shërbime psikosociale për të paktën 20 gra potencialisht të riskuar/të mbijetuar të dhunës në familje në zonën urbane.
- Shërbime psikosociale ofrohen për të paktën tek 40 gra të mbijetuar të dhunës në familje në zonat rurale (minimalisht 10 në secilin fshat).
- Të paktën 60 raste individuale të dhunës në familje janë monitoruar dhe ndjekur.
- Përfaqësimi psikosocial pranë komisarariatit dhe/ose gjykatë u ofrohet të paktën 30 të mbijetuarve/të mbijetuarve të dhunës në familje.
- Këshillimi juridik dhe/ose përfaqësimi në gjykatë u është ofruar 20 të mbijetuarve/të mbijetuarave të dhunës në familje që jetojnë në Sarandë ose katër zonave të tjera të afërta të synuara nga ky projekt: Ksamil, Çukë, Metoq dhe Delvinë.
- Janë zhvilluar takime joformale me Mekanizmin.
- Janë monitoruar vendimet e UM dhe UMM në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.
- Tri Workshop u janë ofruar minimalisht me 30 potencialëve/të mbijetuar të dhunës në familje, të cilët aktualisht janë të papunë dhe jetojnë në Saranda Ksamil dhe Delvina ose katër zonat e afërta të synuara nga ky projekt: Çukë, Metoq, dhe Finiq për të rritur kapacitetet e tyre me aftësi profesionale dhe orientim të punësimit. (Maj 2019)
- Janë organizuar dy Workshop me 15 anëtarë të mekanizmit në Sarandë, Delvinë, (Tetor Nëntor).
- Një trajnim është organizuar me 10 psikologë në Sarandë, Delvinë, Konispol dhe punonjës social në bashki. (Qershor 2019)
- Një veprimtari kulturore ndërgjegjësuere është ngritur për të rritur ndërgjegjësimin për dhunën në familje përmes përfaqësimit retrospektiv të kontributit të grave në zonë. (6 Mars dhe 10 Dhjetor)
- Shfrytëzimi i mediave lokale për rritjen e ndërgjegjësimit në komunitet. (Nëntor-dhjetor 2019)
- Dy ekspozita fotografish me perceptimin e nxënësve 9-vjeçarë për fenomenin e dhunës, format, parandalimin dhe sesi viktimat e mundshme mund të ri-integrohen. Të paktën 20 nxënës/shkollë, dy shkolla, 1 në Sarandë dhe 1 në Delvinë.

Ndërkohë që aktorët e tjerë të mekanizmit si Zyra Arsimore Sarandë, Spitali i Rrethit, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësorë (NJ.V.K.SH) ose ish Drejtoria e Shëndetit Publik, Drejtoria Arsimore dhe Zyra e Përmbarrimit nuk kanë patur asnjë rast të paraqitur apo referuar pranë tyre për dhunë në familje.

Gjithashtu Shërbimi i Provës përgjatë vitit 2019 nuk ka patur raste dhune të referuara nga institucionet e tjera, në zbatim të një UM apo UMM, ndërkohë që përsa i përket të dhënave për veprën penale të parashikuara nga neni 130 i Kodit Penal, “Dhunë në familje”, raste të referuara nga gjykata janë 4, ndër to

2 gra dhe 2 burra. Ku raportet përcillen çdo muaj në Drejtorinë e Përgjithshme të cilat kanë përgjegjësinë për pasqyrimin në faqen elektronike të Ministrisë së Drejtësisë.

Pranë bashkisë Sarandë egziston vetëm Marreveshja e Bashkëpunimit për ngritjen e MKR e lidhur më datë 06.08.2015.

Bashkia nuk ka parashikuar në buxhet zë më vete për aktivitete në kuadër të dhunës me bazë gjinore për forcimin dhe mirëfunksionimin e MKR, por vetëm pagat e punonjësve pranë Zyrës së Politikave Sociale

Për sa i përket aktiviteteve dhe trajnimeve në kuadër të MKR dhe Dhunës me bazë gjinore, kanë marrë disa trajnime mbi funksionimin e MKR dhe legjislacionit nga Shoqata "Jona", ish Ministria e Mireqënies Sociale dhe Rinisë si edhe UNDP, bashkëpunime me PLUDIN, por, të gjitha këto, para vitit 2019, ndërkohë që pargjatë këtij viti nuk ka patur pjesëmarrje në asnjë trajnim.

Gjatë këtij viti asnjë trajnim nuk është realizuar as për koordinatoren vendore apo për anëtarët e MKR-së në Sarandë.

Këtë vit, shoqata "Jona" ka zhvilluar tryeza informuese si edhe një Workshop me anëtarët e MR, me 15 përfaqësues të institucioneve anëtare pjesëmarrës. Janë zhvilluar fushata sensibilizuese nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, si më poshte vijon;

TABELA Nr. 3. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Nr.	Data	Vendi	Tema	Organizuar nga:
1.	16.10.2019	Shkolla "9- Tetori" Sarandë	"Dhuna dhe trafikimi i grave"	Bashkia Sarandë, Zyra Arsimore/Psikologët e shkollave
2.	26.11.2019	Shkolla e mesme "Hasan Tasini" Sarandë	"Si të menaxhojmë zemërimin"	Shoqata "JONA", Zyra Arsimore, Bashkia Sarandë
3.	06.12.2019	Shkolla 9- vjecare, fshati Gjashtë	"Takim Sensibilizues Prindër/ Nxenes"	Shoqata "JONA", Zyra Arsimore, Bashkia Sarandë
4.	10.12.2019	Salla e Bashkisë Sarandë	"Aktivitet Kulturor Sensibilizues"	Shoqata "JONA" Bashkia Sarandë

Burimi: Shoqata "Jona" Sarandë dhe Koordinatorin Vendor.

Megjithëse Objektivi 3.1 i strategjisë kërkon gjithashtu koordinim dhe bashkëpunim ndërmjet pushtetit vendor dhe organizatave me bazë fetare për trajnim dhe organizim të aktiviteteve të përbashkëta për Bashkinë Sarandë një bashkëpunim i tillë ende nuk është institucionalizuar.

Megjithatë ka kontakte ad – hoc dhe ndërveprim ndërmjet strukturave të ndryshme lokale dhe këtyre organizatave. Shpesh organizatat ofrojnë shërbime komplementare ndaj atyre që bashkia nuk i ofron dot. Fokusi kryesor i aktiviteteve të tyre është ndërgjegjësimi dhe puna për nxitjen e një familjeje të shëndetshme. Si edhe ndihmat jetike me ushqime dhe veshmbathje për familjet në nevojë dhe konkretisht viktimat e dhunës në familje që janë mundësuar nëpërmjet Fondacionin "Lidia".

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Mekanzimi i referimit në Bashkinë Sarandë është mbledhur vetëm 2 herë për të njejtin rast, gjatë muajit tetor të vitit 2019. Këto takime presupozohet të kenë qënë për Komitetin Drejtues, por rezultojnë të përbashkëta së bashku me GTN-në. *(Vërtetuar nga listë prezenca e mbajtur në Proces Verbal nga Koordinatori Vendorë, gjatë mbledhjeve të MKR.)* Ndërkohë që Komiteti Drejtues edhe pse parashikuar të mbante një mbledhje gjatë vitit 2019, është anuluar për shkaqe teknike duke mos patur kështu asnjë mbledhje specifike vetëm të KD për vitin 2019.

Megjithatë edhe pse janë zhvilluar vetëm 2 mbledhje, ka patur pjesëmarrje pothuajse të plotë të të gjithë aktorëve të mekanizmit të referimit. Por, jo të përcaktuar nëse Komitet Drejtues apo Grupi Teknik Ndërdisciplinar. Aksione të mire koordinuara midis tyre përgjithësisht janë me shoqërinë civile dhe komisariatit. Por, mungojnë në mbledhje veçanërisht përfaqësuesit e institucioneve si: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Këto institucione marrin pjesë në takime vetëm me përfaqësues të institucionit që përfaqësojnë dhe nuk kanë koordinim të drejtpërdrejtë me institucionet e tjera, përse i përket rolit të tyre në luftën kundër dhunës me bazë gjinore.

Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Sarandë ka qënë pjesë e mbledhjeve të MKR edhe pse nuk është pjesë e Marrëveshjes së Mekanizmit të Bashkërendimit të Rasteve të Dhunës në Familje.

Takimi i MKR bëhet i përbashkët me takimin e Njësisë së Mbrotjes së Fëmijëve për menaxhimin e rasteve të mbrojtjes së fëmijëve në nevojë, kjo pasi mendohet se duke qënë aktorë të përbashkët mbledhjet duhet të zhvillohen bashkë. Ndërkohë, është e paqartë ndarja e mbledhjes së NJMF-së nga i MKR-së, gjithashtu edhe i vetë grupeve përbërëse të MKR, ai i Komitetit Drejtues nga ai i Grupit Teknik Ndërdisciplinar, pasi, nga listë prezenca vihet re, pjesëmarrje dhe përfaqësim institucional jo vetëm nga titullarët sikurse përbëhet KD por edhe nga anëtarët e GTN.

Roli i specialistes për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe fëmijëve të dhunuar, përgjatë vitit 2019, konkretisht Koordinatori Vendor, është i mbivendosur me funksione të tjera në bashki që nuk kanë të bëjnë me çështje të barazisë gjinore dhe dhunës me bazë gjinore siç janë p.sh personat me aftësi të kufizuar, ndihma sociale për familjet në nevojë. Për rrjedhojë, shpesh herë përgjigja kundër dhunës me bazë gjinore kalon në plan të dytë për shkak të mbingarkesës si edhe fluksi i qytetarëve që paraqiten pranë kësaj zyre, të cilët nuk janë te pakët në numër.

Koordinatorja vendore pranë kësaj bashkie ka marrë disa trajnime gjatë viteve të shkuara por asnjë të tillë përgjatë vitit 2019.

1. Çertifikatë, trajnim “Roli i policisë së shtetit në zbatimin e kuadrit ligjor për parandalimin dhe trajtimin e dhunës në familje”, më 22-23 Shkurt 2016. *(Mundësuar nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me UNDP).*
2. Çertifikatë, trajnim “Rritja e kapaciteteve të punonjësve të shëndetësisë për t’iu përgjigjur me profesionalizëm viktimave të dhunës me bazë gjinore”, më 24-25 janar 2013. *(Mundësuar nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës Ceshtive dhe Shanceve të Barabarta dhe UNFPA, akredituar QKEV).*
3. Çertifikatë pjesëmarrjeje, kurs formimi profesional “Kuadri ligjor dhe institucional në zbatimin e politikave të hartuara për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” më 15-16-17 maj

2013. (Mundësuar nga Ministria e Punës, çështjeve dhe Shanceve të Barabarta dhe Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve).

Koordinatorja e MKR-së nuk ka asnjë raport të përmuajshëm apo periodik me antëtarët e MKR-së. Të vetmet dokumentacione që posedon janë marreveshja e MKR, foto nga aktivitetet dhe proces-verbalet e mbledhjeve.

Sistemi i hedhjes të të dhënave “Revalb” në lidhje me statistikat për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel bashkie përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nga ana e Specialistes për Mbrojtjen e të Drejtave të Grave dhe Fëmijëve të Dhunuar sa herë trajtohen raste që komunikohen vendimet e UMM dhe UM, nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Rasti i trajtuar nga MKR i cili paraqitet si rast suksesi, nuk mund të cilësohet si i tillë, pasi është rast i përsëritur dhe pavarësisht përpjekjeve dhe zgjidhjeve që ka dhënë MKR, dhunuesi sërish nuk ka bërë progres.

Përqindja e buxhetit dedikuar shërbimeve dhe shpenzimeve gjatë viti 2019, është 0, pasi Bashkia Sarandë nuk ka të përcaktuar në buxhetin e saj zë të veçantë për realizimin e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore, për publikimin e fletëpalosjeve ndërgjegjësuese apo materiale të tjera të ngjashme.

Nga të dhënat e monitorimit vihet re gjithashtu se për funksionimin e mekanizmit përgjatë vitit 2019 buxheti alokon vetëm pagën e Koordinatorit Vendor të Dhunës dhe 3 punonjësve të tjerë të Zyrës së Politikave Sociale. Pozicioni i Koordinatorit Vendor është krijuar që prej vitit 2015. Është e domosdoshme të rishikohet roli i koordinatorit aktual që të mos ketë mbivendosje dhe lënie pas dore të funksioneve të rëndësishme të koordinatorit, duke e lehtësuar nga përgjegjësitë, meqenëse zyra përfshin 3 Specialistë të Kujdesit Social, ku mund të ndahet puna.

Buxheti i bashkisë Sarandë për strukturën e Zyrës së Politikave Sociale, përmban 4 pozicione me emertesë dhe rroge si më poshtë vijon;

Tabela Nr.4 Buxheti i Zyres se Politikave Sociale sipas Struktures

Pozicioni Punes	Paga Bruto	Paga Neto
Spec. Kujdesit Social	65000	53170
Spec. per mbrojtjen e te drejtave te grave dhe femijeve	61360	50411
Spec. Kujdesit Social	56100	46424
Spec. Kujdesit Social	58560	48288
TOTAL	241.020	198.293
241020 x 12 muaj	2.892.240 lek	
Buxheti total vjetor, i llogaritur nga monitoruesi	(buxhet për 2019 për pagat)	

Burimi: Financë, Bashkia Sarandë

Bashkia Sarandë, bashkëpunon me Komisarjatin e Rrethit Sarandë në referimin e rasteve të dhunës në familje. Kjo marrëdhënie bashkëpunimi është përforcuar si pasojë e punësimit të “Specialistit për Dhunën Familjare dhe të Miturit”, i cili i është përgjigjur gjithmonë pozitivisht thirrjeve për takime apo aktivitete.

Gjithashtu, me Zyrën e Punës Sarandë, ka një bashkëpunim shumë të mirë, pasi titullari pranë kësaj drejtorie ka qënë i gatshëm për të ofruar ndihmë nëpërmjet ndërmjetësimit viktimave të dhunës dhe dhunuesve për integrimin në shoqëri, përmes punësimit, duke përmirësuar ekonominë dhe shkaqet e dhunës në familje.

NJ.V.KSH. ose ish DSHP, ka qënë gjithashtu bashkëpunuese gjatë aktiviteteve të përbashkëta të ndërmara nga OSHC-të në territor. Zyra Arsimore Sarandë, ka qënë bashkëpunuese me Bashkinë Sarandë në realizmin e fushatave ndërgjegjësuese për gratë dhe fëmijët.

Bashkëpunimi me Shërbimin Social është vetëm institucional dhe formal nëpërmjet shkresave percjellëse.

Tabela 5. Numri i mbledhjeve të Mekanizmit të Rasteve të Referimit-së (GTN-ja) në vitin 2019 në Bashkinë Sarandë

<p>1. Takimi i parë u zhvillua në datë 08.10.2019 ora 10:30 në sallën e Këshillit Bashkiak Sarandë, me pjesëmarrjen e 10 personave, përfaqësues nga NJMF dhe GTN nga të cilët 1 mbante Proces Verbal.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbledhje për rastin e pensionistes, dhunuar nga i biri. • Rast i përsëritur në vite. • Në proces verbal nuk janë mbajtur shënime minutat e kohëzgjatjes së mbledhjes.
<p>2. Takimi i dytë u zhvillua më datë 22.10.2019 në sallën e Këshillit Bashkiak Sarandë me pjesëmarrjen e 16 personave, përfaqësues të NJMF dhe MKR (KD/NTN).</p> <p>3. Mbledhja zhvillohet për të njëjtin rast që u mbledh GTN herën e parë, për të ardhur në ndihmë të dyja palëve. Pasi rasti është i përsëritur (momentalisht në paraburgim) dhe përkundrejt ndihmës nga aktorët e MKR, nuk ka bërë progres. Dhunuesi, sipas denoncueses (e dhunara) nuk ushtron dhunë vetëm ndaj saj, por edhe ndaj bashkëshortes. E cila, nuk ka bërë ankesë.</p> <p>4. Në proces verbal nuk janë mbajtur shënime minutat e kohëzgjatjes së mbledhjes.</p>

Burimi: Kordinatorja Vendore, Bashkia Sarandë

Tabela Nr. 6. Grupi Teknik Ndërdisciplinor

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Emanuela Cetri / KV
Komisarjati I Policise	Roland Iljazi
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Nexhi
Prokuroria e Rrethit	Iris Hasani
Zyra e Përmbartimit	Detjona

Zyra e Punës	Elidon Onjea
Drejtoria Arsimore e Rrethit	Bardhyl Maliqi
Nenprefektura	Mirrosh Birjani
NJ.V.K.SH ish Drejtoria e Shëndetit Publik	Argjentina Alikaj
Spitali i Rrethit Sarandë	Marinela Zotaj
OSHC, Shoqata e Gruas "JONA"	Xheni Shehu
Fondacioni "LIDIA"	Orjeta Pipiko
Mjeku Ligjor	Hysen Koronica

Burimi: Kordinatorja Vendore, Bashkia Sarandë

Tabela Nr: 7. Këshilli Drejtues (KD)

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Adi Gurma
Komisarjati I Policise	Syrja Bello
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Sokol Pina
Prokuroria e Rrethit	Lorenc Mërkuri
Zyra e Përmbarimit	Asaf Stroka
Zyra e Punës	Elidon Onjea
Drejtoria Arsimore e Rrethit	Ladi Demaj
Nenprefektura	Mirosh Birjani
NJ.V.K.SH ish Drejtoria e Shëndetit Publik	Arjan Kalcuni
Spitali i Rrethit Sarandë	Erjon Dhroso
OSHC, Shoqata e Gruas "JONA"	Entela Gjoni
Fondacioni "LIDIA"	Ibrahim Bajrami

Mjeku Ligjor	Hysen Koronica
--------------	----------------

Burimi: Kordinatori Vendor, Bashkia Sarandë

Bashkia Sarandë për vitin 2019 nuk ka plotësuar asnjë UMM apo UM.

Nga Bashkia Sarandë nuk janë menaxhuar raste strehimi për në Strehëzën Kombëtare për Viktimat e Dhunës në Familje. Por vetem në strehëzën e kesaj bashkie për 48 orë, viktimë e dhunës në familje nga bashkëshorti, për të cilën nuk u mbajt mbledhje, por u menaxhua në bashkëpunim me Shoqatën “Jona”, pasi strehëza është pa punonjës. Streha në 3 qershor 2020 bën 3 vjet që është ngritur. Ajo, është qendër emergjence 72- orëshë. Nuk ka personel të punësuar pranë qendrës. Por, në rastin e vetëm, të trajtuar pranë kësaj qendre, ka qënë në bashkëpunim me Komisaratin Sarandë dhe Shoqatën “Jona”.

Për vitin 2020 është menduar të lidhet një marrëveshje zyrtare me Policinë e Shtetit për suport sipas rasteve në vazhdimësi.

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin etyre, përmes programeve të specializuara.

Gjatë vitit 2019 në Bashkinë Sarandë, janë dërguar nga Gjykata e rrethit Gjyqësor Sarandë 25 UMM dhe 10 UM, per Rrethin e Sarandës, Njesisë ADM Ksamil dhe fshatrave të saj.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, nuk mban të dhëna statistikore te veçanta për UMM dhe UM të përcaktuara sipas vendbanimit; qytet, periferi apo fshat, moshës, gjinisë, statusit civil, numrit të fëmijëve, nivelit arsimor, statusit të punësimit. Këto të dhëna gjenden pjesërisht në librin themeltar të UM dhe dosjet e vendimeve gjyqësore. Të dhenat jo të plota janë si pasojë e plotesimit të kërkesë padisë nga oficerët e policisë në Komisarati, të cilët nuk i marrin informacion të plotë viktimave të dhunës. Me shqyrtimin e dosjeve dhe vendimeve si edhe të dhënat në librin themeltar të vendimeve, vihet re se tek dokumentacioni i përçuar nga komisarati në gjykatë, formularët tip, janë të pa plotësuar me kredenciale, sidomos të dhenat për të paditurin të cilat janë më së shumti të paplotësuara.

Kjo gjykatë ka të dhëna të rregullta mbi ç’do vendim nëse kërkesa për UMM është pranuar hedhur poshtë apo pushuar, por, jo statistika te veçanta. *(Pasqyruar në librin themeltar te UM)*

³Zyra e përmbarimit në Sarandë ka egzekutuar 70 raste me objekt “pension ushqimor”, 10 raste me objekt “takim fëmijë” dhe 90 raste me objekt “urdhër mbrojtje”.

Në bashkinë Sarandë, nuk ka programe rehabilitimi për dhunuesit dhe as OSHC që ofrojnë të tilla mundësi. Por, gjatë vitit 2019 shoqata “Jona” ka filluar me trajtimin e disa rasteve me kërkesë nga vetë dhunuesit. Gjatë kësaj periudhe 3 kanë qënë rastet e dhunuesve që janë këshilluar nga shoqata.

Konkluzione

³ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit

- Grupit Teknik Ndërsektorial pranë kësaj bashkie nuk ka një listë konkrete për përfaqësuesin e secilit institucion, dhe pjesëmarrësit në mbledhje ndryshojnë herë pas here duke mos patur informacionin e duhur të detyrave dhe përgjegjësiëve për secilin prej tyre.
- Marrëveshja e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit pranë kësaj bashkie është nënshkruar në tetorin e vitit 2015 dhe nuk është rishikuar apo përmirësuar më tutje.
- Institucione të rëndësishme të MKR Sarandë nuk marrin pjesë në mbledhjet e GTN-së dhe kjo sjell një mos-rakordim dhe pengesa në koordinimin e rasteve të viktimave të dhunës në familje.
- Numri i rasteve të trajtuara nga MKR është shumë herë më i ulët sesa numri i rasteve të evidentuara në polici apo Urdhrave të Mbrojtjes të lëshuara nga gjykata pranë kësaj bashkie. Kjo sjell përsëritje të rasteve të dhunës dhe mos dhënie të shërbimeve të duhura për secilën prej viktimave.
- Pranë kësaj bashkie, mbledhjet e GNT-së shpesh quhen mbledhje të Komitetit Drejtues, kur në fakt ato janë mbledhje të grupit teknik. Ndaj është e rëndësishme jo vetëm ndarja në terma por edhe trajnimi I të gjithë anëtarëve të Mekanizmit për funksionimin e duhur të këtij institucioni.
- Në bashkinë Sarandë ashtu si edhe në pjesën më të madhe të bashkive nën monitorim, roli I specialistes (koordinatores) mbivendoset me detyra të tjera në bashki, të cilat nuk kanë të bëjnë me çështje të barazisë gjinore dhe dhunës në familje.
- Koordinatorja pranë kësaj MKR nuk ndan raporte të përmuajshme apo periodike me anëtarët e tjerë, gjithashtu mungon edhe ndarja e dokumentave zyrtare.
- Në Drejtorinë vendore të policisë Sarandë në plotësimin e kërkesë padive nga oficerët e policisë mungojnë të dhenat e plota të denoncuesve, këto kërkesë padi plotësohen vetëm me emër dhe mbiemër duke sjellë kështu problematikë në identifikimin e plotë dhe ndjekjen e rastit.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë në shumë raste në Urdhrat e Mbrojtjes ka informacion të cunguar të mënyrës së komunikimit me viktimat e dhunës. Mungojnë adresat e sakta apo numrat telefonik të kontaktit. Rrjedhimisht këto viktimat nuk kontaktohen nga MKR Sarandë për tu ofruar shërbimet e nevojshme.
- Kjo bashki nuk ka një buxhet të përcaktuar në lidhje me ndërgjegjësimin e komunitetit për të mos pranuar dhunën në familje apo atë me bazë gjinore. I vetmi zë që mbulon buxheti është paga e stafit pranë Zyrës së Politikave Sociale.
- Bashkia Sarandë nuk i është përgjigjur kërkesave të vazhdueshme të organizatave të shoqërisë civile që operojnë në këtë territor dhe japin shërbime për viktimat, për ti bërë pjesë të mekanizmit të referimit.
- Qendra e emergjencës 72 orëshe pranë kësaj bashkie edhe pse po bën tre vjet e ngritur, nuk ka personel dhe i vetmi rast i trajtuar pranë kësaj saj, ka qenë në bashkëpunim me Komisaratin Sarandë dhe Shoqatën “ Jona”.
- Objektivi 3.3 për rehabilitimin e dhunuesve nuk zbatohet në këtë bashki, duke qenë se nuk asnjë program të ngritur zyrtarisht për këtë kategori.

Rekomandime

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Pogradecit për vitin 2019, më poshtë renditen disa rekomandime të cilat kërkojnë masa të menjëherëshme për të

rregulluar funksionimin e Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Sarandë dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ, kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje:

- Rekomandohet një rrishikim i marrëveshjes së mekanizmit për të bërë pjesë edhe Sherbimin e Provës, gjithashtu, rirfreshimi i listes së GTN, pasi, nuk ka nje listë konkrete për anëtarin e GTN për ç' do institucion. Kjo, ndodh, pasi në pjesën më të madhe të këtyre institucioneve janë ndryshuar titullarët e tyre, të cilët kanë bërë edhe firmosjen e MKR-së ne 06.10.2015. Si rrjedhojë, ata nuk kanë informacion të nevojshëm mbi marrëveshjen dhe funksionimit të MKR dhe përfaqësohen nga punonjës të ndryshëm. Prandaj, sugjerohen edhe programe trajnimi për aktorët e mekanizmit.
- Rekomandohet pjesëmarrje e plotë e të gjithë aktorëve të mekanizmit të referimit në mbledhje apo në aksione të koordinuara midis tyre dhe zhvillimin e mbledhjeve të ndara të KD nga ai GTN-së. Veçanërisht institucione si: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë; Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; Prefektura; Spitali. Institucione si Gjykatë dhe Spitali më së shumti nuk marrin pjesë në takime me përfaqesues nga KD, por vetem me Specialist të GTN.
- Duke qënë se roli i Specialistes, përgjatë vitit 2019 ishte i mbivendosur me funksione të tjera në bashki që nuk kanë të bëjnë me çështje të barazisë gjinore dhe dhunës me bazë gjinore, shpesh herë përgjigjia kundër dhunës me bazë gjinore kalon në plan të dytë. Ndaj rekomandohet rishikimi i strukturës (në emërtesë) dhe stafit, duke ndarë përgjegjësitë, në uljen e ngarkesës së Koordinatorit Vendor.
- Koordinatorja e MKR-së duhet të ndajë raporte të përmuajshëm apo periodike me anëtarët e MKR-së dhe dokumenta zyrtare.
- Rekomandohet, krahas proces-verbalit ku duhet mbajtur shënim edhe kohëzgjatja e takimit (minutat), të pranishmit të shënohen jo vetëm Emër/Mbiemër por edhe pozicioni dhe institucioni, të mbahet gjithashtu listë-prezencë më vete e firmosur nga të pranishmit.
- Koordinator Vendor të kërkojë nga anëtarët e mekanizmit raporte të rregullta për ç' do rast të evidentuar në institucionin përkatës.
- Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, të mbahen statistika ose raporte periodike 1-mujore ose 3-mujore, ku të jenë të ndara UMM nga UM, sa janë lëshuar, sa në qytet, sa në fshat, sa të plotësuar nga gjykata, sa civile, sa penale, sa të pushuara, sa të rrezuara, sa të pranuar. Si dhe mosha, arsimi, gjinia, femije te mitur te perfshire (sa dhunues gra sa burra).
- Rekomandohet komisarati, duke u referuar edhe tek rekomandimi ndaj Gjykatës, pika më lart në vazhdim rrjedhës, pasi, puna çalon tek plotësimi i kërkesë padisë nga oficerat e policisë, të cilët nuk i marrin të dhëna të plota denoncuesëve gjatë plotësimit të formularit tip të policisë.
- Përsa i përket përqindjes së buxhetit që i dedikohet funksionimit të MKR-së ai i përgjigjet vetem pagave te stafit, por, duke mos patur të përcaktuar buxhet tjetër si zë të veçantë për aktivitete kundër dhunës, bie efektiviteti i mekanizmit, duke sjellë mos funksionimin e MKR, ndaj rekomandohet rishikimi i këtij zëri sidomos për realizmin e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore, për publikimin e fletëpalosjeve ndërjegjësuese apo materiale të tjera të ngjashme
- Bashkia të zhvillojë aktivitete përpos programeve të implementuara nga OSHC-të, gjatë vitit kalendarik në vazhdim, me iniciativën e saj dhe mbështetje dytësore të aktorëve. Pasi, mungesa e tyre nxit përgjegjesi dhe interes të ulët, nga ana e bashkisë, për të bërë progres në luftën kundër dhunës me bazë gjinore, duke ngelur gjithmonë në rolin mbështetës.
- Rekomandohet që bashkia të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me aktorët e mekanizmit (institucionet) për një bashkëpunim më të mirë dhe gjithëpërfshirës, si edhe të rishikohet kërkesa për bashkëpunim e organizatave të cilat janë vepruese dhe mbështetëse me bashkinë Sarandë.

Për më shumë informacion në lidhje me këtë raport kontaktoni

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

E-mail: gadc@gadc.org.al

Adresa: Rr. “Abdyl Frasheri” Pallati 10/1, shk.1, ap.3, Tiranë